



01/Nr./222/2020
Data:18.02.2020

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e parë -I- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.01.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlasi (Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtore për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtore për Buxhet dhe Financa), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e termetit në Republikën e Shqipërisë.
3. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hani të Elezit për vitin akademik 2019/2020.
4. Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.
5. Miratimi i planit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2020.
6. Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.
7. Shqyrtimi i informatës mbi veprimtarit afariste.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- para se me diskutuar për pikat e rendit të punës nga një kopje të rregullores së punës së kuvendit ua kam sjellë dhe mundësisht kërkoj që të respektohet. Është mirë të respektohet neni 31, neni 32, neni 33, neni 39, neni 40, neni 41. Pushim për dy apo tri orë nuk kemi, kush do mund të del dhe kthehet në seancë. Krahas këtyre pikave të rendit të punës kemi edhe një material shtesë që ju është dërguar ndërkohë. Lidhur me pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- si material shtesë keni pranuar propozim vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtore të shkollave. Në bazë të udhëzimit administrativ numër 15/2019 për përzgjedhje të drejtorëve të shkollave, Drejtoria e Arsimit është e obliguar të formojë komision i cili përbëhet prej tre anëtarëve. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket pikës shtesë me që e parashihet ligji do ta votojmë për, ndërsa te çështja e rregullores unë pajtohem që t'i përmbahemi rregullores por unë mendoj që duhet të keni një pikë tolerance për me u diskutuar çështjet pavarësisht asaj, e jo me thyer ligjin apo rregulloren por nuk besoj që kishte vlerë me shkuar bash strikt për shkak se nëse jemi dakorduar që me mirëkuptim me i diskutuar çështjet nuk ja vlen me bërë të madhe këtë punë.

Florim Shkreta thekson:- kjo rregullore a vlen edhe për kryesuesin e kuvendit dhe nëse vlen ulëset të cilat i keni afër me kryetarin nuk është mirë. Unë asnjë herë nuk e kam thyer rregulloren për ndonjë qëllim të caktuar dhe ndoshta ndonjë herë kemi dal jashtë pikave të rendit të punës por kemi pasur mirëkuptim. Unë çdo herë jam munduar me respektuar rregulloren brenda mundësive dhe ndoshta ndonjë herë e kemi shkelur por pa qëllim është bërë dhe unë do të jem i njëjti si kam qenë. Kuvendi i ka 15 anëtarë dhe nuk jemi në Kin që me qenë 200 persona e mos me na ardhur rendi me diskutuar. Nëse jemi në kuvendë për me i diskutuar gjërat për të mirën e Hanit të Elezit nuk është mirë me shkuar në këtë formë.

Kryesuesi thekson:- unë nuk kam asgjë kundër askujt por çdo kush do ta ketë drejtën e fjalës dhe nëse e kalon minutazhën do t'i lejohet shtesë, mirëpo problemi është që të respektohet sepse është mirë edhe për juve edhe për mu. Besoj që do të shkon puna më mirë dhe strikt nuk e kërkoj me u zbatuar por me respektuar rregulloren.

Mefail Suma thekson:- shpesh më mendojnë fjalët e mia pse fola kam dëshirë të më dëgjoni dhe të më kuptoni sepse këtu është një komunitet që nuk marrin vesh sepse shikon se kush fol dhe çka tha por nuk e shikojnë atë se çka është esenca. Unë mund të mos diskutojë hiq por kjo po doket që po e bëni për shkak të opozitës. Unë mendoj se opozita është konstruktive. Është mirë që kur të miratohen çështjet të shënohet se e kundërshtoi opozita.

Teuta Shkreta thekson:- edhe në mandatin e parë kemi pas rregullore dhe kuvendi ka qenë në nivel sepse tre apo katër anëtarë jemi prej mandatit të kaluar por është mirë që mos të stërgjatët sepse për shkak lodhjes që kuvendi ka zgjatë nga katër apo pesë orë i kemi shkyej pyetjet të cilat kemi pasur në plan me i parashtruar. Unë mendoj që kuvendit mos të stërgjatët të jetë cilësorë, kualitativë dhe sa më i shkurtër.

Akif Shkreta thekson:- konsideroj se njohja me rregulloren vazhdimisht nuk është ndonjë problem edhe nëse dyshon kryesuesi ose ndonjë asambleistë që është shkelur rregullorja nuk është ndonjë problem por është sqarim. Është viti i gjashtë që jam në kuvend dhe kam probleme me njohjen e rregullores dhe ndoshta çdo kush ka probleme dhe është normale që mos me njohur për shkak se e kemi një kulturë të përgjithshme që nuk lexojmë vazhdimisht për me i njohur rregulloret dhe ligjet. Ideja është që shpesh herë dhe brengë që më duket mua është që dalim jashtë rendit të punës dhe kjo krijon një problematikë. Secila pikë është e vërtetë që mund të lidhet dhe kemi pikën për ndarjen e bursave për studentë dhe kjo është e vërtetë që ka me arsim por nuk ka të bëjë për shkollat dhe për suksesin e nxënësve.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë diskutim sa i përket materialit shtesë, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e termetit në Republikën e Shqipërisë.
3. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2019/2020.
4. Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.
5. Miratimi i planit të punës së tri komiteve konsultative për vitin 2020.
6. Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.
7. Shqyrtimi i informatës mbi veprimtarit afariste.
8. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Ilaz Thaçi" në Han të Eezit.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- propozoj që procesverbalet e KKSB-së dhe procesverbalet e bordit të drejtorëve me najë përcjell me material.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare me rastin e tërmetit në Republikën e Shqipërisë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- për ngjarjet në Shqipëri që kanë ndodhë në vitin e kaluar në atë kohë ishim të interesuar me ndarë mjete financiare por buxhet nuk ka pasur. Në këtë mbledhje kemi propozuar shumë për me ndarë mjete financiare brenda mundësive buxhetore që kemi duke vlerësuar shumën 10000 € ja vlen që të ipet për tërmetin në Shqipëri.

Samire Curri thekson:- e përshëndes propozimin e kryetarit të komunës për ndarjen e mjeteve financiare për ndihmë shtetit shqiptarë Shqipërisë me rastin e tërmetit në qytetin e Durrësit dhe në Thumanë. Si pasojë e këtij tërmeti pati humbje në njerëz dhe dëme materiale dhe shuma e propozuar nga kryetari i komunës nuk mund t'i përballon të gjitha dëmtimet atje por sa do pak të i dalim në ndihmë popullit tonë.

Mehmet Ballazhi thekson:- është kërkesë e gjithë neve që të ndihmohet për çështje të tërmetit sepse kemi diskutuar edhe në mbledhje tjera por në mbledhje të komitetit për politik e financa kërkoja që kjo shumë e mjeteve financiare të ndahet në dy pjesë dhe atë 5000 € të dedikohen për ndihmë në Shqipëri dhe 5000 € në KPF kam propozuar për shoqatën e bletarëve sepse kanë parashtruar kërkesa dhe nuk janë mbështetur asnjë herë. Më urgjente dhe më imediate dhe më e nevojshëm ishte plotësimi i mungesës së listës esenciale të barnave në Han të Elezit dhe besoj që kohët e fundit e kanë vërtetuar të gjithë të tjerët të cilët kanë pasur nevojë me shkuar se ka mungesë të shumtë të barnave. Unë propozoj që 5000 € të ndahen për shëndetësi në mënyrë urgjente në mënyrë që të plotësohet lista e barnave esenciale brenda mundësive dhe pjesa tjetër të ndahet për Shqipëri për shkak se shuma 10000 € është e vogël në krahasim me kërkesat që janë për me i kryer të gjitha dëmet që janë bërë prej tërmetit. Në trajnim që ishim diskutuam me disa përfaqësues të disa komunave për këtë dhe komuna e Vitisë i kishte ndarë 4000 € ndihmë Shqipërisë, e që ishte shumë simbolike me një buxhet rreth dymbëdhjetë milionë euro. E arsyeshme mu duk që ne me i dhënë 5000 € për shkak se më shumë tregon shpirti human se sa shuma e mjeteve sepse kemi nevojë në ambulantë me plotësuar listën e barnave esenciale për një kohë të caktuar. Në bisedë e sipër me qytetarë shumica i kanë blerë vetë barnat por ka prej atyre që nuk kanë mundur me i blejë.

Sabrije Krasniçi thekson:- mendojë që nuk është e nevojshme me ndarë shumë 10000 € sepse është e nevojshme me i ndihmuar por nuk është shumë e madhe por edhe e vogël nuk është. Unë mendoj që ka pika tjera prej buxhetit që mundemi me i ndarë për në ambulantë siç është ndërtimi i banesës sociale që nuk mendoj që në këtë vit ka me u realizuar ajo pikë dhe prej asaj pike me i zhvendosur te shëndetësia.

Mefail Suma thekson:- unë e pëlqejë këtë propozim vendim por është pak me vonës sepse një herë na është thënë se nuk ka mjete financiare dhe po më duket që ka humbur efekti. Siç shihet propozim vendimi i kryetarit të komunës nuk është i regjistruar askund dhe a ekziston si akt normativë dikund ai propozim vendim i kryetarit të komunës i nënshkruar. Nëse ekziston nuk ka nevojë me na i sjell neve si propozim vendim por duhet të quhet në bazë të propozim vendimit të kryetarit të komunës me numër dhe të kësaj date kuvendi i komunës merr vendim dhe pastaj nënshkruhet nga kryetari i kuvendit. Duhet të hiqet fjala propozim dhe të jetë vendim mbi ndarjen e ndihmës momentale sepse për ndarjen e mjeteve mundë të konsiderohet i gjatë një afat por kjo është një ndihmë momentale.

Bajrush Laçi thekson:- si propozim vendim është në rregull nuk ka diçka probleme dhe juridikisht është në rregull shkresa e kryetarit të komunës është e nënshkruar. Propozim vendimi do të votohet në kuvend dhe në momentin kur do të votohet ai plotësohet bëhet vendim dhe përpunohet te zyra e sekretarisë dhe pastaj dërgohet në Ministri të Pushtetit Lokal dhe ata e vlerësojnë ligjshmërinë e vendimeve dhe zakonisht nuk kemi pasur probleme. Si procedurë mendoj që është mirë dhe ajo që u potencua mendoj që nuk është në rregull sepse numri i shkresës përcjellëse që është protokolluar shënohet në vendim dhe në momentin kur ju e votoni e nënshkruar kryesuesi i kuvendit dhe atëherë proceduralisht është në rregull.

Mefail Suma thekson:- te pika gjashtë shënon ky vendim hyn në fuqi 15 dite dhe a është vendim apo është propozim vendim për shkak se lartë shënon propozim vendim sepse nuk mund të jetë kontradiktorë.

Nora Xhoni thekson:- unë mendoj se edhe si shumë edhe si vendim është në rregull. Shuma prej 10000 € është në rregull dhe prej kësaj shumë nuk kemi mbetur për me blerë barna apo me investuar diçka për shkak se kemi shuma të tjera për me i diskutuar dhe me i ndarë me kohë. Është diskutuar dhe miratuar buxheti kemi mundur me kohë me i planifikuar dhe me i ndarë mjetet financiare. Unë mendoj që shuma që është propozuar është në rregull dhe propozim vendim është i hartuar mirë dhe kërkoj që të vazhdohet më tutje.

Teuta Shkreta thekson:- sa i përket shëndetësisë në nivel komunal besoj që jemi shumë në rregull dhe nëse kemi bërë një kërkesë për 24 orë është miratuar kërkesa emergjente , ndërsa sa i përket ministrisë nuk mundemi me ndërhyrë. Si komunë jemi shumë në rregull për shkak se nëse shkohet në komuna të tjera të gjitha duhet me i blerë përveç shërbimeve që kryhen prej personelit shëndetësorë.

Florim Shkreta thekson:- po më vjen keq kur diskutojnë disa sikur mos me ja ditur hallin vetit. Unë mendoj se nëse kemi miliardat dhe me i dhënë për Shqipëri është mirë sepse dëshira është e madhe por mundësia është e kufizuar. Si komunë nëse i ndalim shumën 5000 € e nuk e dërgojmë nuk është ndonjë far dëmi për Shqipërinë , ndërsa për te na ndikon. Unë propozoj që këto mjete të ndahen për shkak se kemi nevojë si komunë , mirëpo nëse i keni premtuar ambasadorit të Shqipërisë nuk është ndonjë problem mund të ndajmë edhe më shumë.

Sead Vila thekson:- shuma e cila është paparë në propozim vendim nuk është diçka që e zgjidhë problemin dhe nevojat që i kanë bashkëkombësit tonë por megjithatë është një solidarizim siç kemi vepruar në aspektin moral dhe afaristë shumë të cilët kanë ndihmuar. Unë mendoj që kjo shumë sa do modeste mos të ndahet por të shikohen mundësit e tjera për nevoja të tjera në shërbime apo sektore që nevojiten sepse janë situata që ne duhet të solidarizohemi. Unë e mbështesë këtë propozim vendim sepse është një shumë modeste.

Nora Xhoni thekson:- pasi patë diskutime të ndryshme nga parafolësit të gjithë e dimë që shumën prej 6000 € është e planifikuar për pushim në Shqipëri me ndarë për ata që diskutuan parafolësit.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk e di pse u hiperbolizuar kjo çështje sepse kjo ishte një ide dhe një mendim i imi sepse në KPF kam kërkuar me u ndarë si subvencion për bletarë, mirëpo vetë u ballafaqova me mungesën e barnave të cilën vetë e pashë dhe prej ankesave të tjera që kam pasur prej qytetarëve. Po më vjen shumë keq prej parafolësës z. Teuta Shkreta sepse as unë dhe askush nuk potencojë diçka që nuk është në rregull për shkak se kujdesi është shumë i mirë dhe u kyç jashtë asaj që potencova. Atë që unë deshta ta potencojë është mungesa e barnave dhe nuk po e potencojë vetëm unë por e potencojnë të gjithë ata të cilët ishin në ambulancë. Kjo ishte një ide që nuk patë nevojë me hiperbolizuar por është mirë që të hidhet në votim nëse kalon mirë nëse nuk kalon si për mua si për gjithë të tjerët në Han të Elezit është njëjtë se nuk jemi tu i marr për keq përdorim të ideve apo të mjeteve. Unë kam paraparë si ide me dhënë në këtë mënyrë dhe nëse nuk miratohet nuk ka diçka të keqe por kjo po merret sikur për inati pse e potencoj dikush dhe ju ballafaqoi fundi fundit bashkë me mua. Unë kërkoj që të del si propozim për votim dhe nuk kisha dashur shume me hiperbolizuar.

Kryesuesi thekson:- kjo është emergjente dhe ju që kërkon me marr shuma dhe me i dërguar te shëndetësi ne e kemi pasur miratimin e buxhetit dhe është dashur atëherë me planifikuar , ndërsa kjo është emergjente dhe i kemi planifikuar 10000 € dhe nuk jam i pajtimit që këtë shumë me ndarë këtë shumë e cila është emergjente.

Rufki Suma thekson:- ekzekutivi i komunës bënë propozim vendim ndërsa vendimin e merr kuvendi i komunës. Ne kemi propozuar për ndarjen e mjeteve financiare dhe nuk është pikë e rendit të punës ndarja e buxhetit sepse buxheti është miratuar për vitin 2020. Në dhjetorë të vitit 2019 nuk ka pasur mjete financiare sepse ishim në përfundim të buxhetit dhe këto mjete financiare merren nga kategoria për subvencione dhe nuk kemi drejtë me marr prej kategorisë tjetër por vetëm prej subvencioneve. Para dhjetë dite është alokuar një e dymbëdhjeta pjesë e buxhetit për vitin 2020 dhe është alokuar një pjesë e buxhetit dhe është bërë propozim vendim. Për çdo vit kemi dhënë subvencione që drejtoria për bujqësi pylltari dhe zhvillim rural bënë propozim për subvencione dhe ne kemi të ndarë buxhet për subvencione në bujqësi që i kemi subvencionuar bletarët, lopët qumështore dhe për kategoritë e ndryshme. Në planifikimet tona është edhe sektori i bletarisë. Në QKMF kur janë alokuar mjetet tani ka pasur kërkesë nga QKMF-ja për urgjencë dhe menjëherë kemi filluar me procedura urgjente për me siguruar pajisje të domosdoshme që janë edhe pse ju të gjithë e dini që QKMF-të e kanë listën e pajisjeve esenciale që financohen prej ministrisë dhe përveç asaj për çdo vit komuna jonë ka blerë barna esenciale më tepër se 10000 €. Organizata "Islamic Relief" participon 35,000.00 € në shtimin e personelit pranë QKMF-së dhe në këtë vit është planifikuar që të shtohen edhe vizitat shtëpiake. Në QKMF është e vërtetë që ka pasur mungesa por me i dedikuar edhe 20 000 € nuk kanë me mjaftuar për shkak se mesatarja në ambulancën tonë brenda këtij muaji ka shkuar deri në 200 vizita për shkak të gripit. Kur të bëhet bartja e mjeteve financiare nga viti 2019 në vitin 2020 do të kemi mundësi me i dedikuar mjetet në shëndetësi apo me ndonjë kod më tepër.

Mehmet Ballazhi thekson:-mjetet mund të dedikohen por në radhë të parë është emergjencia dhe më rast emergjent që e kemi shëndetësinë nuk mund të themi me dilema sepse është rast emergjentë dhe nga disa parafolës u përmend buxheti dhe kjo e nënkupton që është planifikuar keq, e që do të thotë nëse planifikimit bëhen keq edhe buxheti miratohet keq. Në buxhet është dashur me paraparë mjetë për shkak se mund të ketë ndonjë epidemi. Nga kjo del se nuk ka ndonjë trajtim dhe elaborim të çështjeve emergjente. Mjetet mund t'i dedikojmë edhe për shëndetësi por ju e keni paraparë dhe mund të vazhdoni më tutje e mos ta bëjmë të madhe këtë problem

Mefail Suma thekson:- si kryetarë i komunës a keni nënshkruar propozim vendimin të cilin na e keni përcjellë.

Rufki Suma thekson:- propozim vendimi është i nënshkruar dhe i protokolluar.

Kryesuesi thekson:- propozim vendimi është i nënshkruar dhe i protokolluar por është përcjellë në vord sepse më lehtë me u përcjell materialet dhe me u qel më lehtë. Propozimin e z. Mehmet Ballazhi që shuma 5000 € të dedikohet për shëndetësi, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 4 për 11 kundër. Propozim vendimi që shuma prej 10000 € të dedikohet për Shqipëri, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për, 4 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE ME RASTIN E TERMETIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

3. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentë në komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2019/2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- me ligj të vetëqeverisjes lokal janë të përcaktuara vendimet e kryetarit të komunës, vendimet e drejtorit dhe vendimet e kuvendit të komunës dhe në kuvend dërgohen propozim vendimet prej kryetarit ose prej drejtorive. U konsultova me sekretarinë materialet të cilat i përcillen kuvendit të gjitha janë të nënshkruara dhe të protokolluara por dërgohen në këtë mënyrë që më lehtë me u qelë. Sa i përket propozim vendimit bursat ndahen sipas rregullores që është e miratuar nga ana e kuvendit të komunës. Kuvendi për çdo vit duhet ta përcakton numrin e studentëve, shumën e mjeteve financiare dhe me i përcaktuar fakultete prioritare.

Samirë Curri thekson:- te fakulteti i bujqësisë të jetë edhe fakulteti i bioteknologjisë ushqimore për shkak se si komunë kemi nevojë për inspektorë të ushqimit.

Nora Xhoni thekson:- propozoj që jetë Fakulteti i Gjuhës Angleze dhe Fakulteti i Gjuhës Gjermane.

Akif Shkreta thekson:- te fakulteti i mjekësisë mos të specifikohet Mjekësi e Përgjithshme - Stomatologji por të jetë si tërësi si fakultet i mjekësisë duke marrë parasysh që në Han të Elezit nuk kemi asnjë pediatër.

Sead Vila thekson:- në momentin që janë shënuar drejtimet mësimore mos të evidentohen secila në veçanti sepse te secila prej tyre që janë përmendur ka edhe drejtime të tjera.

Sabrije Krasniçi thekson:-propozoj që prioritet të jetë edhe fakulteti i edukimit në përgjithësi.

Mefail Suma thekson:- te mjekësia prioritet duhet ti ipet gjinekologjisë sepse Hani i Elezit ka nevojë.

Teuta Shkreta thekson:- unë mendoj që duhet të jetë fakulteti i mjekësisë së përgjithshme sepse aty hyjnë të gjitha lëmit.

Florim Shkreta thekson:-unë kisha propozuar që mos të përqendrohemi shumë në këto fitra që po ua japim studentëve por të përqendrohemi te ata studentë që diplomojnë për shkak se kemi kuadër të cilët e kanë kryer veterinarinë dhe bredhin rrugëve dhe nuk mund të punësohen, kurse si komunë kemi nevojë për një veterinarë.

Kryesuesi thekson:- nuk është mirë të thuhet fitër sepse kjo është bursë.

Menduh Vlasi thekson:- unë mendoj që fitra nuk janë sepse ipen 50 € dhe me zbritje të çmimeve që janë 35€ e paguan konviktin dhe ushqimin dhe 15 € i mbeten dhe nuk është pak. Sa i përket profileve të gjithë kanë të drejtë me konkuruar por në profile prioritare kemi potencuar që ka prioritet. Nëse e shënojmë mjekësinë hyjnë edhe infermierët dhe nuk kemi nevojë për shkak se ka shumë pa punë. Nëse shënohet edukim kemi shumë të cilët e kanë kryer dhe për atë potencova që duhet të specifikohen. Sa i përket mjekësisë që u përmend drejtimi i gjinekologjisë dhe pediatriisë por është specializim dhe nuk është drejtim i fakultetit dhe ne e kemi shënuar mjekësia e përgjithshme dhe stomatologjia për me u ikur tjerave.

Sabedin Hasallari thekson:- kërkoj sqarim për drejtimin të cilin e keni propozuar Bioteknologji në Zootekni. Është mirë që drejtimet e bujqësisë me i përkrahur më tepër.

Menduh Vlasi thekson:-drejtimet i kemi marrë prej fakulteteve dhe nëse kërkon j'u mund t'i hekim dhe mund t'i shtojmë.

Rufki Suma thekson:- vitin e kaluar kanë marr të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për bursa dhe nuk e shohë të arsyeshme me u cunguar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR BURSA PËR STUDNETË NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN AKADEMIK 2019/2020

4. Miratimi i planit të punës së komitetit për komunitete për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- në KPF kemi dhënë vërejtjet tona për shkak se komiteti në fjalë planin e punës e ka njëjtë sikur të kuvendit të komunës dhe më shumë është dashur me pas pika rreth komunitetit. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Teuta Shkreta thekson:- në komitet për komunitete punohet dhe anëtarët janë mjaft aktiv por është problemi sepse këtu nuk kemi komunitet pakicë por kemi dhënë kontribut. Kemi diskutuar pika dhe nuk e shohë ndonjë ndryshim të madh me komitetin për politik e financa sepse edhe në komitet për komunitete punohet.

Akif Shkreta thekson:- është komision obligativ dhe nuk po hyjmë në çështjet të cilat janë paraparë sipas rregullores por ky komunitet ndonjë herë keqkuptohet për shkak se mendohet që bëhet fjalë për pakica dhe nuk ka të bëjë me pakica por ka të bëjë me tërë komunitetin me grupet e interesit dhe duhet të trajtohen ato çështje. Në atë komitet duhet diskutohen çështjet nëpër fshatra, të diskutohet takimi me komunitetin e fshatit Seqishtë për çështjen e arsimit e jo të diskutohet plani i kuvendit për shkak se është kompetencë ekskluzive e kuvendit të komunës. Komisioni ka nevojë për këshilla se si me hartuar atë plan.

Mefail Suma thekson:- anëtarët e këtij komiteti vërehen që nuk i lexojnë rregulloret për shkak se ky komitet duhet ta ketë rregulloren e vetë të punës sepse në rregullore potencohet roli dhe kompetencat që i kanë. Përveç pikave që i ka planifikuar është mirë që për çdo muaj ta shtonë ndonjë pikë rreth komuniteti sepse pak flitet për komunitet.

Florim Shkreta thekson:- komitetit bënë punë por ekzekutivi na ka ofenduar se drejtorët nuk kanë marr pjesë në takime gjë që shihet edhe në këtë mbledhje të kuvendit të komunës mungesa e drejtorëve. Në komitet janë diskutuar gjërat por në mungesë të drejtorëve ndonjë herë nuk kemi mundur me i diskutuar gjërat sepse kanë munguar drejtorët.

Sead Vila thekson:- kjo që është planifikuar në plan nuk është ajo që e kanë detyrë dhe në përgjegjësi sepse ky komunitet nuk është vetëm për pakica etnike. Çdo grup që i ka disa veçori homogjen të përbashkëta etnik, racorë apo fetarë sepse me sa kam informacione është komitet prej kuvendit dhe prej qytetarëve që është komision me parë sa më afër shqetësimet e qytetarëve.

Teuta Shkreta thekson:- plani është hartuar nga tjetër kush edhe pse disa prej anëtarëve qenkan pjesë e kuvendit të komunës por është problemi që ky komunitet ka qenë aktiv dhe nuk mund të themi që nuk ka punuar asgjë. Për punën e këtij komuniteti janë edhe procesverbalet që para disa viteve kemi diskutuar për vërshimet dhe pas një dite ndodhi vërshimi në lagje të re. Është diskutuar për fshatrat për shkollat dhe për çështje të tjera.

Kryesuesi thekson:- nuk jemi te diskutuar që nuk punohet por jemi te diskutuar planin e punës së këtij komiteti i cili ka mundur të ketë edhe pika tjera jashtë kuvendit brenda kompetencave të veta.

Mehmet Ballazhi thekson:- e kemi diskutuar edhe më herët se kemi vërejtur edhe të komitetit për komunitete edhe te komitete konsultative që nuk përputhet plani me kompetencat që i kanë sepse shihet që është kopjuar prej planit të punës së kuvendit të komunës. Është mirë mos me miratuar këtë plan se sa me miratuar dhe me kaluar formalisht kështu. Është mirë që anëtarët e komiteteve ne të diskutojnë dhe ta hartojnë një plan tjetër për shkak se plani që është propozuar nuk i përmbushë interesat e komuniteteve as komitetit për komunitete as për komitete konsultative dhe është shumë formale nëse e miratojmë kështu sepse komiteti duhet t'i paraqet shqetësimet e qytetarëve.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj që në mbledhje të komitetit për komunitete të marrin pjesë edhe drejtorët.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për, 1 abstenim.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITEIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

5. Miratimi i planit të punës së tri komiteteve konsultative për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- këto komitete me udhëzim administrativ i kanë paraparë që t'i mbajnë nga gjashtë mbledhje. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- është mirë të shtohen pikat e rendit të punës brenda kompetencave që kanë. Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale që sipas ligjit ka shtatë kompetenca dhe më intereson kompetenca e katërta që parasheh të shqyrton masa përkatëse për mbështetjen komunale grupeve të varfëra komunale të njerëzve (invalidëve të luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetim, të pastrehët, të rikthyerit). Unë mendojë që ka shumë për me diskutuar për këto çështje e që asnjë herë nuk është dërguar ndonjë material se çka ka diskutuar ky komitet. Komiteti për Arsim, Kulturë dhe Sport i ka 13 kompetenca. Komiteti për zhvillim ekonomik te pika tre potencon shqyrtimin dhe propozimin e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Komiteti për shëndetësi që është i kam lexuar rregulloret e komunave të tjera dhe kryesuesi i komitetit merr pjesë në mbledhje të bordit të drejtorëve. A merr pjesë kryesuesi i këtij komiteti ndonjë herë në mbledhje të bordit të drejtorëve dhe unë mendojë që asnjë herë nuk merr pjesë. Rregulloret ekzistojnë dhe këto komitete ne t'i lexojnë dhe me drejtorët e njësive përkatëse kanë nevojë me bashkëpunuar për shkak se nuk i dinë çështjet në mënyrë që t'i dinë përgjegjësit e tyre.

Sabrije Krasniçi thekson:- komiteti konsultativ për arsim nuk është marr me arsimin por është marr me raportin e punës së kuvendit të komunës sepse nuk ka asnjë lidhshmëri arsimit me këtë pikë. Komiteti për zhvillim ekonomik ka planifikuar të diskutoj për llogaridhënien e kompanisë "Sharrcem" dhe përgjegjësin e "Sharrcemit". Nëse shkon për me i kërkuar llogaridhënie çfarë llogari dhënie do t'i kërkon kompanisë "Sharrcem" për ndotje të ambientit dhe a ka fakte për këtë çështje. Duhet të kemi fakte për kërkuar llogari ndaj kësaj kompanie.

Sead Vila thekson:- te këto komitete vërehet që temat janë më të harmonizuara dhe më të përshtatshme me punën të cilën e kanë. Përveç planeve a bëjnë raporte dhe a përcillet në kuvend raporti i punës.

Kryesuesi thekson:- raport paraqesin dhe do ta keni për diskutim. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për, 2 abstenim.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË TRI KOMITETVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2020

6. Miratimi i planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- plani është hartuar në bazë të udhëzimit administrativ dhe rregullores për bashkëpunim me këshillat lokale. Udhëzimi i ri administrativ parasheh që të mbahen gjashtë mbledhje për vitin 2020.

Mefail Suma thekson:- a janë formuar këshillat lokale në bazë të vendimit të cilën e kemi marr në kuvend. Potencuat që plani i punës është hartuar në bazë të rregullores së këshillave lokale a janë harmonizuar pikat në bazë të asaj rregullore. Këshilli i fshatrave i ka kompetencat sikur komitete konsultative dhe është mirë që secilit këshill të fshatrave të ju ipet nga një rregullore kopje.

Teuta Shkreta thekson:- këta këshilla nëse janë funksional mund të japin kontribut shumë të madh. Këshilli i fshatrave duhet të jetë i informuar për bujqësinë për blegtorinë dhe për çdo gjë që ndodhë në atë fshat. Këshilli i fshatrave duhet të jetë i informuar edhe për rastet sociale dhe të i identifikon personat të cilët e kanë gjendjen e keqe materiale dhe ata familje që kanë nevojë për ndërtim të shtëpive.

Florim Shkreta thekson:- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural a mund të na mbështes si komunitet i fshatit Seqishtë për shkak se bëhet fjalë për pyllëzim të një pjese në fshatin tonë. A ka mundësi komuna me na mbështetët me mjete financiare apo me ndonjë formë tjetër sepse jemi në bisedime me një shoqatë Turke por kemi nevojë për mbështetje edhe prej komunës. Si këshill i fshatit kemi kërkuar më herët edhe në kompaninë “Sharrcem” por ata kanë potencuar se çdo ndihmë që shkon duhet përmes komunës, mirëpo është mirë që komuna me na mbështetur në mënyrë që ai projekt mos të dështon.

Edon Curri thekson:- këshillat nuk janë themeluar.

Kryesuesi thekson:- rregullorja është e publikuar në gazetën zyrtare të komunave, ndërsa për pyetjen që parashtroj z.Florim Shkreta drejtoria jep përgjigje te të ndryshmet. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin 13 këshilltarë të kuvendit të komunë).

7. Shqyrtimi i informatës mbi veprimtarit afariste.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sabedin Hasallari thekson:- janë paraqitur 309 biznese dhe kërkoj informacion se a i kryejnë obligimet të cilat i kanë ndaj komunës dhe obligimet tjera ndaj nivelit qendrorë sepse dua ta dijë se a janë të gjitha aktive që e ushtrojnë veprimtarinë. Inkasimi për vitin 2019 është inkasuar në shumë prej 95,296.40 € që do të thotë se ka pasur një ngritje por sa ka inkasuar borxhe nga viti paraprakë. A janë inkasuar borxhet ashtu siç janë planifikuar për vitin 2019 dhe nëse janë inkasuar do të thotë se është një sukses . A ka në komunën tonë biznese që e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë ilegale dhe nëse ka biznese të vogla duhet të regjistrohen qoftë nëse kanë edhe një punëtorë.

Rufki Suma thekson:- sa i përket inkasimit nuk janë inkasuar vetëm burxhet e vitit 2019 por ka edhe nga vitet e kaluar për shkak se në fund të vitit edhe tatimit në pronë edhe bizneseve ju është dhënë vërejtje për me i kryer obligimet. Kompanitë kanë nënshkruar marrëveshje me komunën për me i kryer borxhet paraprake.

Teuta Shkreta thekson:- është kompetencë e komunës apo e Ministrisë kontrollimi i çmimeve nëpër makete për shkak se çmimet janë të ndryshme.

Rufki Suma thekson:- çështja e çmimeve nuk është në kompetencë të komunës.

Sead Vila thekson:- totali i bizneseve është 309 dhe shihet që në aspektin gjinore biznese me pronare femra qenkan 40 e që në përqindje i bien 13 % , ndërsa në aspektin faktik gjendja nuk është kështu dhe ndoshta juridikisht është. Femrat vetëm i regjistrojnë bizneset në emër të tyre por nuk janë udhëheqëse të bizneseve dhe duhet tu epet përparësi atyre që duan me ecur me biznese përpara.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të rendit të punës të paraparë sipas agjendës.

8. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Ilaz Thaçi” në Han të Eezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sabedin Hasallari thekson:- anëtari që është propozuar nga këshilli i prindërve a merret për bazë kualifikimi personal për shkak se duhet të vlerëson.

Menduh Vlasi thekson:- te anëtari i komisionit nga ministria dhe nga komuna kërkohet që të ketë kualifikim baraz peshë , ndërsa te i prindërve nuk kërkohet por ne e kemi përzgjedhë që është me kualifikim.

Florim Shkreta thekson:- a janë në dioni këta persona që janë propozuar për anëtarë të komisionit sepse po dëgjohet se po shkojnë si dhunshëm nëpër komisione sepse nuk po e kryejnë punën ashtu siç po ua thotë shpirti dhe siç duhet por detyrohen në mënyra të tjera.

Menduh Vlasi thekson:- anëtari i komisionit nga ministria dhe nga komuna janë të njoftuar , ndërsa znj. Vlora Suma është kryetare e këshillit të prindërve të shkollës dhe është dashur ta respektojmë ligjin për barazi gjinore. Nuk jemi konsultuar me të por nuk besojë që paraqet ndonjë problem.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për 3 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR DREJTOR TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT “ILAZ THAQI”

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- sa i përket pyllëzimit nuk kemi ndonjë projekt për pyllëzim për këtë vit për shkak se nuk kemi pasur ndonjë vend. Sa i përket pyllëzimit në fshatin Seqishtë është pak problem se kafshët e dëmtojnë. Si komunë prej subvencioneve do të mundohemi me dhënë këshilla dhe punëtorët të cilët janë me kontrata nëse vazhdohet projekti me i angazhuar gjatë mbjelljes. Është mirë që me biseduar me komunitetin e fshatit Seqishtë që mos me i lëshuar bagëtinë dhe dy vitet e para kur është thatësi e madhe me i ujitur.

Hanumshahe Dibrani thekson:- peshat e rënda të çantave për fëmijët filloristë është shqetësim seriozë jo vetëm për nxënësit por edhe për prindërit. Kërkoj nga drejtorja e arsimit që të vendosë dollapë nëpër shkolla sepse fëmijët po kanë probleme me boshtin kurrizorë dhe është shqetësim i madh për të gjithë.

Menduh Vlasi thekson:- këtë problem e kemi diskutuar edhe në Ministri të Arsimit dhe në komunë por për çështje të dollapëve nuk i kemi ndarë mjetet për këtë vit, mirëpo nëse do të kemi mjete financiare mundemi me bërë. Në ministri të arsimit janë duke punuar që mësimi tërë ditorë me u zhvilluar dhe nëse bëhet mësimi tërë ditorë klasa është e tyre dhe mund t'i lënë aty sepse kemi raste në komunë të Prishtinës që mësimi është tërë ditorë.

Florim Shkreta thekson:- për çështje të ujit e kemi një alternativë dhe do të bisedojmë edhe më gjerësisht që me mundur me na mbështetur edhe ju si komunë në mënyrë që mos me dështuar projekti. Kërkoj përgjigje me shkrim për vendimin e përjashtimit të nxënësit që është bërë në shkollën e mesme “Dardania”. Sa mirënjohje i ka dhënë kryetari i komunës në vitin 2019? Përgjigjet nuk më janë dhënë për çështjen e prejardhjes së parcelës dhe përgjigje nuk më është dhënë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Kryesuesi thekson:- përgjigje të është dhënë dhe i ke konsumuar dhe për çështje të atij dokumenti mund të shkoni në gjykatë.

Florim Shkreta thekson:- gjërat i ke keqkuptuar sepse personalisht nuk kam asgjë por në mënyrë institucionale e kam kërkuar komunës dhe nëse komuna nuk ka përgjigjen duhet ta kërkon në mënyrë institucionale në Gjykatë. Për disa gjëra akuzohet pushteti i më hershëm dhe ju duhet t’i gëzoheni fakti që është mirë që është duke u kërkuar dhe ti del në anën e kundërt dhe vazhdimisht më keqkupton.

Mefail Suma thekson:- kërkoj që të na ipet nga një kopje e marrëveshjes së kryetarit të komunës me kompaninë “Bifurkacioni”. Kërkoj që të na ipet nga një kopje e marrëveshjes së kryetarit të komunës me Ministrinë e Transportit për ato dy punëtorët të cilët e kryejnë regjistrimin e veturave .

Sead Vila thekson:- kërkoj që të më ipet materiali i kuvendit i vitit 2019. Punën e kuvendit po e marrim si dytësore dhe për disa aktivitete disa të tjerë shkuan. Nuk po më duket etike prej strukturës sonë sepse s’po i përmbahemi disa sendeve për shkak se aktivitet dytësore po i bëjmë prioritare ndërsa kjo është më prioritare.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:09

Procesmbajtësi

Axhi Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava